

MANUAL PËR INFORMACION DETYRUES TË ORIGJINËS

Deklaratë

Duhet theksuar se ky dokument nuk përbën një akt ligjërisht të detyrueshëm dhe është i një natyre shpjeguese. Aktet ligjore dhe nënligjore në fushën doganore në Republikën e Shqipërisë kanë përparësi mbi përmbajtjen e këtij dokumenti.

Tabela e përbajtjes

Hyrje

Kushtet për aplikim për një Vendim IDO.....	5
Mënyrat për aplikim për vendim IDO dhe elementet për t'u paraqitur.....	6
Pranimi i një aplikimi për IDO.....	10
Marrja e vendimit IDO.....	11
Përdorimi i një vendimi IDO.....	15
Përfundimi i vlefshmërisë së një vendimi IDO.....	16

HYRJE

Manuali "Udhëzues mbi Informacionin Detyrues të Origjinës (IDO)", ka si objektiva:

- Të lehtësoj zbatimin uniform të dispozitave përkatëse të përcaktuara në ligjin nr.102 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".
- Të ofroj udhëzime për autoritetin doganor me qëllim lëshimin e IDO.
- Të ofroj informacion për operatorët ekonomik mbi mënyrën e aplikimit të një vendimi IDO.

Një vendim IDO ofron siguri ligjore për operatorët ekonomik në lidhje me përcaktimin e origjinës, lehtëson punën e shërbimeve doganore dhe kontribuon në interpretimin uniform të rregullave të origjinës.

Vendimi IDO është detyrues për autoritetin doganor kundrejt mbajtësit dhe për mbajtësin kundrejt autoritetit doganor.

Procedurat dhe fazat që lidhen me dhënien e vendimit IDO janë si më poshtë:

- Kushtet për të aplikuar për një vendim IDO;
- Mënyrat për të paraqitur një aplikim IDO dhe elementet që ofrohen;
- Pranimi i një aplikimi IDO;
- Marrja e vendimit IDO;
- Përdorimi i vendimit IDO;
- Përfundimi i vlefshmërisë së vendimit IDO ;

1. KUSHTET PËR TË APLIKUAR PËR NJË VENDIM IDO

1.1 Aplikuesi duhet të ketë një numër identifikimi NUIS/NIPT. Vendosja e numrit të identifikimit NUIS/NIPT dhe përfaqësimi bëhet në përputhje me nenin 24, nenin 27 pika 2 të Kodit Doganor, dhe nenin 19 pika 1 gërmë a të VKM nr.651 datë 10.11.2017 (Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor).

Çdo operator ekonomik i cili aplikon për një vendim IDO mund të përfaqësohet. Ky përfaqësim mund të jetë direkt, në rastin kur përfaqësuesi vepron në emër dhe për llogari të operatorit ekonomik ose i tërthort kur përfaqësuesi vepron në emër të tij (ai do të jetë mbajtësi i vendimit), por kryen veprime për llogari të operatorit ekonomik.

Një operator ekonomik i vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duhet të regjistrohet pranë autoritetit doganor nëse aplikon për një vendim (neni 19 pika 2 Kodi Doganor), në mënyrë që të pajiset me një numër identifikimi NUIS/NIPT, në përputhje me nenin 11 pika 1 gërmë a, (Dispozitat Zbatuese).

Kur një operator ekonomik është vendosur jashtë Shqipërisë, mund të jetë më e përshtatshme të caktohet një përfaqësues i tërthortë që ka një numër identifikimi NUIS/NIPT, për të aplikuar për një vendim IDO. Në mënyrë që të mundësohet përdorimi i një vendimi IDO, deklarata doganore për të cilën IDO do të përdoret duhet të paraqitet dhe në emër të përfaqësuesit të tërthortë.

1.2 Aplikimi duhet të dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas nenit 33 pika 1, Dispozitat Zbatuese.

1.3. Aplikimi duhet t'i referohet vetëm një lloji malli dhe një grupi rrëthanash për përcaktimin e origjinës neni 33 pika 4, Dispozitat Zbatuese).

“Një lloj malli” nënkuption që mallrat në fjalë të janë të klasifikuara në të njëjtin kre tarifor. “Një grup rrëthanash për përcaktimin e origjinës” nënkuption se mallrat janë përfstuar nën kushte identike duke përdorur të njëtin proces prodhimi dhe materiale ekuivalente, të cilat kanë të bëjnë specifiksht me përcaktimin e statusit origjinues dhe atë jo-origjinues.

1.4. Një aplikues mund të paraqesë vetëm një kërkesë për të njëjtat mallra dhe të njëjtat rrëthana në përcaktimin e origjinës (neni 36 pika 1 shkronja a, Kodi Doganor).

1.5. Aplikimi duhet të jetë e lidhur me synimin e përdorimit të vendimit IDO ose përdorimin e parashikuar të një procedure doganore (neni 36 pika 1 shkronja b, Kodi Doganor)

1.6. Kushte të tjera që duhet të plotësohen parashikohen në nenin 27 pikë 1, (Kodi Doganor) dhe nenin 33 pika 2 dhe pikë 6, (Dispozitat Zbatuese).

Aplikimi duhet të përbajë të gjithë informacionin e kërkuar në mënyrë që Autoritetet Doganore të janë në gjendje të marrin vendimin. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të verifikojë nëse është dhënë i gjithë informacioni i nevojshëm për pranimin e aplikimit. Informacioni i konsideruar i nevojshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave që mundëson përcaktimin e origjinës së mallrave do të verifikohet imtësisht vetëm pas pranimit të aplikimit. Aplikuesi është përgjegjës për dhënien e informacionit lidhur me marjen e vendimit. Gjatë procesit të marrjes së vendimit nëse është e nevojshme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të kërkojë informacion shtesë.

Në momentin e paraqitjes së një aplikimi për një IDO, aplikuesi pranon që të gjitha të dhënat e vendimit, duke përfshirë çdo fotografi, imazhe dhe broshura, me përjashtim të informacionit konfidencial, të bëhen publike nëpërmjet faqes së internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Çdo bërje publike e të dhënavë duhet të respektojë të drejtën e mbrojtjes së të dhënavë personale.

2. Mënyrat për të paraqitur një aplikim IDO dhe elementet që duhen pasqyruar

2.1 Mënyrat për të paraqitur një aplikim IDO parashikohen në nenin 33 pika 6, (Dispozitat Zbatuese). Aktualisht, do të pranohet vetëm aplikimi përmes formularit specifik të paraqitur në Aneksin 11 “Aplikimi për Informacionin Detyrues të Origjinës”, të shtojcës C të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, por në të ardhmen mund të ketë një sistem elektronik. Kur të ketë një sistem elektronik përdorëzimin e kërkesave për një vendim IDO aplikimet do të të bëhen përmes këtij sistemi (neni 17 Kodi Doganor dhe nen 33 pika 6, Dispozitat Zbatuese).

Aplikimi duhet të paraqitet në mënyrën e mëposhtme:

- Plotësohen kutitë e formularit të dhënë në Aneksin 11 “Aplikimi për Informacion Detyrues të Origjinës”, të Shtojcës C Dispozitave Zbatuese dhe dorëzohet pranë DPD dorazi ose nëpërmjet postës.
- Mund të jenë disa persona, që mund të aplikojnë dhe të pajisen me vendim IDO (neni 27 pikal paragrafi 2, Kodi Doganor).

2.2 Elementet që duhen pasqyruar në aplikim Aneksi A, Shtojca A e Dispozitave Zbatuese.

Elementet e të dhënave të nevojshme për aplikimin IDO trajtohen në Aneksin A “Kërkesat e përbashkëta të të dhënave për kërkesat dhe vendimet” të Shtojcës A, Dispozitat Zbatuese.

1/1 LLOJI I KODIT TË APLIKIMIT

Formulari i aplikimit për “Informacionin Detyrues të Origjinës (IDO)” është formulari i përcaktuar në Aneksin 11, të Shtojcës C (Dispozitat Zbatuese). Në titullin e tij shfaqet kodi IDO.

1/ 2 Nënhkrimi / Autentifikimi

Në rastet kur aplikimi dorëzohet dhe nënhkruhet nga një përfaqësues, i cili ka prokurë përfaqësimi me të drejtë nënhkrimi, kjo prokurë duhet të vihet në dispozicion të autoritetit doganor dhe duhet të paraqitet sipas kërkesës të tij.

Kur të ngrihet një sistem elektronik për aplikimet për IDO, të gjitha aplikimet për IDO duhet të bëhen përmes këtyre mënyrave dhe personi i cili dorëzon aplikimin (aplikuesi ose përfaqësuesi) duhet të njihet nga sistemi përmes regjistrimit.

2/1 Aplikime dhe vendime të tjera në lidhje me informacionin detyrues të mbajtësit

Aplikuesi duhet të tregojë nëse ai ka aplikuar më parë ose ka marrë një vendim IDO përmallra identike ose të ngjashme, për të njëjtën bazë ligjore dhe të pasqyroj numrin e regjistrimit të aplikimit dhe/ose numrin e referencës së vendimit.

Kur një vendim i IDO është lëshuar përmallra identike apo të ngjashme dhe për të njëjtën bazë ligjore por nuk është më i vlefshëm, ose kur periudha e vlefshmërisë së një vendimi IDO është afér përfundimit, autoriteti doganor mund të pranojë aplikimin e ri, nëse janë plotësuar të gjitha kushtet e tjera për pranimin e aplikimit. Kjo është e nevojshme për arsyen vazhdimësisë së aktivitetit të operatorit ekonomik.

Gjithashtu, aplikuesi ose përfaqësuesi i tij duhet të tregojë nëse ai ka aplikuar, ose ka marrë një vendim IDT për mallra identike si dhe të pasqyrojë numrin e regjistrimit të aplikimit dhe/ ose numrin e referencës së vendimit.

2/2 Vendimet lidhur me informacionin detyrues të lëshuar ndaj mbajtësve të tjera

Aplikuesi duhet të pasqyrojë nëse ai ka informacion në lidhje me një vendim IDT për mallra identike ose të ngjashme, për të njëjtën bazë ligjore. Nëse ka, ai mund të tregojë gjithë informacionin që disponon lidhur me këtë informacion detyrues, veçanërisht numrin e referencës për të cilin ai është në dijeni, datën e fillimit të vlefshmërisë së vendimit IDT, kodin e nomenklaturës të pasqyruar në vendimin IDT.

Qëllimi i pasqyrimit të këtij elementi të të dhënave është për të siguruar përcaktimin e saktë dhe uniform të origjinës.

Aplikuesi duhet të tregojë, nëse ai ka informacion në lidhje me një vendim IDT për mallra identike. Nëse ka, ai duhet të tregoj çdo informacion lidhur me këtë informacionin detyrues.

2/3 Procedurat ligjore ose administrative në proces ose të mbyllura

Aplikuesi duhet të tregojë nëse ka informacion, në lidhje me çdo procedurë ligjore ose administrative në proces lidhur me origjinën, apo në lidhje me ndonjë vendim gjyqësor mbi origjinën të dhënë për mallrat në fjalë. Nëse ka informacion, ai duhet të tregojë emrin dhe adresën e gjykatës, numrin e referencës së rastit në proces dhe/ose numrin e vendimit, apo çdo informacion tjetër.

Qëllimi i pasqyrimit të këtij elementi të të dhënave është për të siguruar përcaktimin e saktë dhe uniform të origjinës.

2/4 Dokumentet bashkangjitur

Aplikuesi duhet të tregojë numrin total të dokumenteve të bashkangjitura dhe të japë një listë të informacioneve bashkëngjitur. Duhet të japë informacion mbi llojin dhe nëse është e zbatueshme, numrin e identifikimit dhe datën e lëshimit të dokumentit/eve bashkëngjitur aplikimit.

Nëse një dokument bashkangjitur përmban informacion shtesë mbi një element të caktuar të të dhënave të kërkua në aplikim, aplikuesi duhet të tregojë një referencë për elementin e të dhënave në fjalë.

3/1 Aplikuesi i vendimit

Aplikuesi duhet të tregojë emrin dhe adresën e tij. Në rast të përfaqësimit të tërthortë, duhet të vendoset emri dhe adresa e përfaqësuesit.

3/2 Identifikimi i Aplikuesit për vendim

Aplikuesi duhet të tregojë numrin e identifikimit **NUIS/ NIPT**. Në rast të përfaqësimit të tërthortë, duhet të tregohet numri i identifikimit **NUIS/ NIPT** i përfaqësuesit.

3/3 Përfaqësimi

Nëse aplikuesi është i përfaqësuar direkt, ai duhet të tregojë emrin dhe adresën e tij. Nëse kërkohet, përfaqësuesi duhet të japë një kopje të kontratës përkatëse, prokurën e përfaqësimit ose ndonjë dokument tjeter që vërteton statusin e përfaqësuesit.

3/4 Identifikimi i Përfaqësuesit

Nëse aplikuesi është i përfaqësuar direkt, ai duhet të pasqyrojë numrin e identifikimit NUIS/ NIPT të tij.

3/6 Personi i Kontaktit përgjegjës për aplikimin

Aplikuesi duhet të japë emrin dhe detajet e personit të kontaktit, (kjo përfshin një numër telefoni dhe adresë e-maili). Personi i kontaktit është përgjegjës për mbajtjen e kontaktit me doganën përsa i përket aplikimit dhe mund të kontaktohet nga autoriteti doganor për çdo lloj informacioni në lidhje me aplikimin.

4/1 Vendi

Aplikuesi duhet të tregojë vendin në të cilën aplikimi është nënshkruar ose në rast të përdorimit të Sistemit Elektronik është autentikuar në mënyrë elektronike.

4/2 Data

Aplikuesi duhet të tregojë datën në të cilën ka nënshkruar, apo është autentikuar aplikimi (në rast të përdorimit të Sistemit Elektronik).

4/3 Vendi ku mbahen dhe aksesohen llogaritë kryesore për qëllime doganore

Ai duhet të tregojë vendin ku mban llogaritë e tij kryesore për qëllime doganore të evidentuara tashmë në elementin e të dhënavë 3/2 (Identifikimi i aplikuesit për vendim).

Nëse aplikuesi është një Operator Ekonomik i Autorizuar (OEA) nuk është e nevojshme të japë këtë informacion.

5/1 Kodi i Mallrave

Aplikuesi duhet të tregojë kreun/nënkreun (kodin e nomenklaturës doganore) të produktit që është objekt i aplikimit. Kodi i nomenklaturës doganore duhet të jetë i detajuar në një masë të mjaftueshme për të identifikuar mallrat dhe rregullin për përcaktimin e origjinës.

Nëse aplikuesi është mbajtës i një vendimi IDT për të njëjtat mallra, ai do të tregojë kodin e nomenklaturës së përcaktuar në vendimin IDT.

Është i rëndësishëm referimi i versionit të saktë të nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar e cila përditësohet çdo 5 vjet dhe në disa raste mund të çojë në krerë të rinj të Sistemit të Harmonizuar.

5/2 Përshkrimi i mallrave

Aplikuesi duhet të përshkruajë mallrat në mënyrë që të mundësojë identifikimin e tyre. Ky përshkrim duhet të përmbarë kryesisht emrin tregtar, referencën tregtare, madhësinë, ngjyrën, shenjat e mallrave etj.

7/1 Lloji i Transaksionit

Aplikuesi duhet tē shēnojë nēse aplikimi ka tē bējē me njē transaksion importi ose eksporti, duke specifikuar transaksionin e parashikuar pēr tē cilin synohet tē pērdoret vendimi IDO.

8/4 Mostrat etj.

Aplikuesi mund tē vendosë nē dispozicion ndonjë fotografi, broshura apo dokumente tē tjera lidhur me pērbērjen e mallrave dhe materialevë pērbërëse tē tyre, tē cilat mund tē ndihmojnë nē pērshkrimin e procesit tē prodhimit ose pērpunimit që i nēnshtrohen materialet. Nēse kērkohet nē mēnyrë specifike nga autoriteti doganor, duhet tē paraqitet edhe njē mostër.

8/5 Informacion shtesë

Aplikuesi mund tē japë çdo informacion shtesë, nēse konsiderohet e nevojshme.

III/1 Baza Ligjore

Aplikuesi duhet tē tregojë bazën ligjore pēr tē vlerësuar originën e produktit sipas rasteve:

- nēse aplikimi ka tē bējē me pērcaktimin e origjinës jo preferenciale, aplikuesi duhet tē vendosë nenin 59 tē Kodit Doganor; nēse aplikimi ka tē bējē me pērcaktimin e origjinës preferenciale, aplikuesi duhet tē vendosë nenin 63 tē Kodit Doganor dhe marrëveshjen me shtetin/tet nga ku mallrat, që ai synon tē pērdorë nē vendimin IDO pērfitojnë nga masat preferenciale.

III/2 Pērbērja e mallrave

Aplikuesi tregon pērbērjen e mallrave dhe çmimin e tyre Ex-Works (çmimi i fabrikës), kur ky informacion është i nevojshëm pēr pērcaktimin e origjinës.

III/3 Informacioni që mundëson pērcaktimin e origjinës

Pēr zbatimin e rregullit tē origjinës, kur është e nevojshme, duhet tē jepen informacionet e mēposhtme:

- informacione nē lidhje me materialet¹ e pērdorura: origjinën (tē pērcaktuar nē tē njëtin kuadër ligjor si ai i pērdorur pēr produktin final), klasifikimin tarifor (duhet tē jetë tē paktën nē nivel 4-shifror, 6-shifror, nē varësi tē rregullit), vlerën dhe peshën.
- informacione nē lidhje me proceset ose pērpunimet që kryhen: mund tē pērfshihen vendi i proceseve, rendi kronologjik i proceseve, natyra e proceseve tē kryera (metoda e prodhimit, makineritë e pērdorura, eksperiencia e nevojshme dhe çdo informacion shtesë që mund tē jetë i dobishëm).

Aplikuesi duhet tē tregojë rregullin e origjinës pēr t'u zbatuar dhe originën e parashikuar pēr mallrat pēr tē cilat ai jep informacionin.

Informacioni i dhënë i mundëson autoritetete doganore tē pērcaktojnë origjinën e mallit. Megjithatë, saktësia e informacionit mbetet përgjegjësi e aplikuesit që jep informacionin.

Kur procesi dhe materialet e pērdorura janë tē ndryshme nē dy ose më shumë produkte, edhe nē qoftë se

¹ Material do tē thotë çdo ingredient, komponent, pjesë, etj tē pērdorura nē prodhimin e produktit

këto produkte kanë të njëjtin emër tregtar duhet të dorëzohen aplikime të veçanta.

III/4 Përcaktimi i të dhënave që duhet të trajtohen si konfidenciale

Aplikuesi duhet të përcaktojë në rast se ndonjë nga të dhënat duhet të trajtohet si konfidenciale.

III/7 Çmimi Ex-Works/çmimi i fabrikës

Aplikuesi duhet të tregojë çmimin, Ex-Works² të produktit për të cilin kërkohet përcaktimi i origjinës. Ky informacion i mundëson autoritetit doganor të përcaktojë origjinën e produktit. Megjithatë, saktësia e informacionit mbetet përgjegjësi e aplikuesit që ofron informacionin.

3. Pranimi i aplikimit për IDO

3.1 Marrja dhe regjistrimi i aplikimit (neni 27 pika 2 Kodi Doganor)

Aplikimi duhet të regjistrohet nga DPD, Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës. Kërkesës duhet t'i caktohet një numër reference. Aplikuesi duhet të njoftohet për marrjen dhe regjistrimin e aplikimit. Njoftimi duhet të përbajë datën dhe numrin e referencës së caktuar nga DPD.

Ky njoftim mund të bëhet në disa forma: e-mail, letër ose një njoftim elektronik kur të jetë ngritur një sistem elektronik për menaxhimin e aplikimeve IDO.

3.2 Verifikimi i kushteve dhe pranimi i aplikimit bëhet në përputhje me këto dispozita (neni 27 pika 2, neni 36 pika 1 shkronja a dhe b (Kodi Doganor); neni 19 pika 1 shkronja a, b dhe c; neni 29 pika 1, 2 dhe 3 neni 33 pika 6 (Dispozitat Zbatuese))

Kur aplikuesi ka paraqitur të gjitha elementet e të dhënave të detyrueshme (Aneksi 11, Shtoja C dhe Aneksi A, Shtoja A Dispozitat Zbatuese), DPD duhet brenda 30 ditëve nga marrja e aplikimit për një vendim IDO, të verifikojë nëse janë përbushur kushtet për pranimin e atij aplikimi.

Sektori i Origjinës, në Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës që pranon aplikimin duhet të shqyrtojë dhe kontrollojë elementët e mëposhtëm:

- nëse aplikimi për IDO nuk është bërë më parë nga vetë aplikuesi apo në emër të mbajtësit të një vendimi në lidhje me të njëjtat mallra dhe në të njëjtat rrëthana që përcaktojnë vlerësimin e origjinës.
- nëse aplikimi i referohet një përdorimi të synuar të vendimit IDO ose një përdorimi për një regjim doganor të parashikuar.

Më pas, do të kontrollohet nëse plotësohen kushtet e tjera të përcaktuara në nenin 19 të Dispozitave Zbatuese, si dhe nëse aplikuesi zotëron një NUIS/ NIPT.

Për më tepër, një aplikim për një vendim IDO duhet t'i referohet vetëm një lloji malli dhe një grupi rrëthanash për përcaktimin e origjinës.

Nëse aplikimi është në përputhje me pikat e mësipërme mund të pranohet, data e pranimit është data e dorëzimit të aplikimit. Megjithatë, kur autoriteti doganor përcakton se nuk ka informacion të mjaftueshmë për të pranuar aplikimin, ai do t'i kërkojë aplikuesit, brenda 30 ditësh, të japë

² Termi Ex-Works/çmimi i fabrikës është përcaktuar në çdo kuadër ligjor

informacionin e nevojshëm shtesë. Ky informacion shtesë duhet të jepet brenda një afati kohor të arsyeshëm që nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në këtë rast, data e pranimit të aplikimit është data kur autoriteti doganor ka marrë informacionin e fundit shtesë.

Kur aplikimi nuk është në përputhje me pikat e mësipërme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk do ta pranojë atë dhe do të informojë aplikuesin brenda 30 ditëve.

Neni 19 pikat shkronja ç, Dispozitat Zbatuese, thekson se një aplikim për një vendim nuk do të pranohet kur ai ka të bëjë me një vendim që ka të njëjtin qëllim si një vendim i mëparshëm, drejtuar të njëjtët aplikues i cili, gjatë periudhës një vjeçare para aplikimit, është anulluar apo revokuar me arsyetimin se aplikuesi nuk ka përbushur një detyrim të atij vendimi.

Aplikimi do të pranohet përsa kohë ai, nuk ka të bëjë me një vendim tjetër IDO i cili, është anuluar apo revokuar me arsyetimin se aplikuesi nuk arriti të përbushë detyrimet e atij vendimi.

Në bazë të nenit 18 shkronja a, Dispozitat Zbatuese, kur aplikimi nuk pranohet aplikuesi nuk gëzon të drejtën për t'u dëgjuar. Kur aplikimi është pranuar, njoftimi do të përcillet duke evidentuar datën e fillimit të pranimit të aplikimit.

4. MARRJA E VENDIMEVE IDO

4.1 Afati i marrjes së një vendimi IDO (neni 27 pika 3 Kodi Doganor dhe nenit 21 pika 1 Dispozitat Zbatuese).

Vendimi IDO duhet të lëshohet brenda 120 ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Periudha 120 ditë mund të zgjatet maksimumi me 30 ditë, nëse autoriteti doganor e konsideron të nevojshme këtë zgjatje për të shqyrtuar informacionin e dhënë. Edhe pse rastet janë të kufizuara, në rast se konsiderohet e nevojshme kryerja e një analize laboratorike dhe është e pamundur të realizohet brenda një afati 30 ditor, kjo periudhë mund të zgjatet. Autoriteti doganor duhet të njoftojë aplikuesin mbi arsyet për këtë zgjatje të afatit.

4.2 Shqyrtimi i elementeve të parashikuara në aplikim

Në qoftë se gjatë shqyrtimit të elementeve të parashikuara në aplikim, autoriteti doganor konstaton se nuk ka të gjithë informacionin që mundëson përcaktimin e origjinës apo që informacioni i dhënë është dukshëm i gabuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet t'i kërkojë aplikuesit të japë informacionin e duhur brenda një afati kohor të arsyeshëm i cili nuk duhet të kalojë 30 ditë.

Kur është kerkuar informacion shtesë nga aplikuesi, dhe ky informacion nuk është paraqitur brenda afatit të përcaktuar, apo kur informacioni i dhënë nuk i mundëson autoritetit doganor përcaktimin e origjinës, nuk lëshohet IDO. Aplikuesit i lëshohet një vendim ku shpjegohen arsyet pse nuk mund të lëshohet një IDO. Në këtë vendim mund të bëhet me dije fakti që aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri, kur ai të ketë siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm.

4.3 Mënyra e plotësimit të kutive të formularit të vendimit (Shtojca A, Aneksi A “Kërkesat e përbashkëta të të dhënave për kërkesat dhe vendimet”; Shtojca B, Aneksi 12-02 “Vendimet e informacionit Detyrues të Origjinës”, Dispozitat Zbatuese.

1/1 Tipi i Kodit të Vendimit

Tipi i kodit të vendimit IDO shfaqet në krye të titullit të formularit të vendimit.

1/2 Nënshkrimi/Autentifikimi

Vendimi nënshkruhet nga Shefi i Departamentit në varësi të së cilës është Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, i cili merr vendimin mbi IDO. Vendimi duhet të vuloset me vulën e institucionit.

Në rast të përdorimit të sistemeve elektronike të menaxhimit të aplikimeve, do të ketë një proces vërtetimi të autenticitetit elektronik.

1/6 Numri i referencës së vendimit (kutia 2, 11 dhe 13 e formularit të vendimit IDO)

Numri i referencës së vendimit duhet të strukturohet si vijon: AL (kodi i shtetit) – numri serial i IDO,

1/7 Autoriteti doganor kompetent (kutia 1 e formularit i vendimit IDO)

Në këtë kuti tregohet emri dhe adresa e DPD.

2/1 Aplikime dhe vendime të tjera të mbajtura në lidhje me informacionin detyrues (kutia 15 dhe 16 e formularit të vendimit IDO)

Nëse aplikuesi ka treguar se ka aplikuar për një IDO, apo se ka marrë një vendim IDO për mallra identike ose të ngjashme për të njëjtën bazë ligjore, në vendim duhet të tregohet numri i regjistrimit të aplikimit ose numri i referencës së vendimit të dhënë më parë.

Nëse aplikuesi ka treguar se ai ka aplikuar ose ka marrë një vendim IDT për mallra identike, në vendim duhet të tregohet numri i regjistrimit të aplikimit ose numri i referencës së vendimit të dhënë më parë.

2/2 Vendimet referuar informacionit detyrues të lëshuar mbajtësve të tjerë (kutia 15 dhe 16 e formularit të vendimit IDO)

Nëse aplikuesi ka përmendur se ai është në dijeni të një vendimi IDO për mallra identike ose të ngjashme dhe për të njëjtën bazë ligjore në zbatim, ky informacion do të pasqyrohet në kutinë 15 të formularit të vendimit. Nëse aplikanti ose përfaqësuesi i tij ka përmendur vendimin IDT për mallra identike në aplikim, ky informacion pasqyrohet në kutinë 16 të formularit të vendimit.

3/1 Mbajtësi i vendimit (kutia 3 e formularit të vendimit IDO)

Në çdo rast, aplikuesi për një vendim IDO bëhet automatisht mbajtësi i vendimit. Emri dhe adresa e aplikuesit, vendoset në kutinë 3 të formularit të vendimit IDO.

3/2 Mbajtësi i vendimit (kutia 3 e formularit të vendimit IDO)

Numri i identifikimit të NUIS/ NIPT të mbajtësit duhet të pasqyrohet në kutinë 3 të formularit të vendimit IDO.

4/1 Vendi

Vendi ku është marrë vendimi IDO.

4/2 Data

Data në të cilën është lëshuar vendimi IDO.

4/6 Data e fillimit të vendimit [E kërkuar].(kutia 4 e formularit të vendimit IDO)

Data e fillimit të vendimit në të cilën fillon vlefshmëria e vendimit IDO. Kjo datë i referohet datës në të cilën është marrë vendimi në lidhje me IDO (4/2) dhe nuk mund të jetë me efekt prapa veprues.

4/7 Data e skadencës së vendimit (shih “Shënime të përgjithshme mbi formularin e vendimit IDO”)

Data në të cilën përfundon vlefshmëria e vendimit IDO.Vlefshmëria e vendimit IDO përfundon 3 vjet pas datës së fillimit të vlefshmërisë.

5/1 Kodi i mallit.(kutia 6 e formularit IDO)

Kreu/nënkreu ose kodi 8-shifror i klasifikimit në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave siç tregohet në aplikim. Vendimi merret në përputhje me kodin e mallit të pasqyruar në aplikim.

Është i rëndësishëm referimi në versionin e saktë të nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar e cila përditësohet çdo 5 vjet dhe në disa raste mund të sjell krijimin e krerëve të rinj në Sistemin e Harmonizuar.

5/2 Përshkrimi i mallrave (kutia 7 e formularit të vendimit IDO)

Mallrat duhet të përshkruhen në mënyrë të mjaftueshme për të mundësuar identifikimin e tyre pa asnjë dyshim dhe duke bërë lehtësish të mundur lidhjen e mallrave të përshkruara në vendimin IDO me mallrat e paraqitura. Më konkretisht, emri i produktit dhe referimi i tij tregtar duhet të jetë i mjaftueshëm për të përbushur këtë kërkesë.

6/3 Shënime të përgjithshme

DPD do të pasqyroj në një kuti të veçantë informacionin e mëposhtëm:

"Pa cënuar dispozitat e nenit 37 pika 4 dhe nenit 37 pika 5 të Kodit Doganor vendimi IDO është i vlefshëm për 3 vjet nga data e fillimit të vendimit. Mbajtësi i vendimit IDO duhet të jetë në gjendje të provojë se mallrat në fjalë dhe rr Ethanat që përcaktojnë origjinën e tyre, përputhen në çdo aspekt me mallrat dhe rr Ethanat e përshkruara në vendim".

7/1 Lloji i transaksionit (kutia 8 e formularit të vendimit IDO)

Në kutinë 8 të formularit të vendimit IDO autoriteti doganor evidenton llojin e transaksionit i cili është parashikuar dhe vendosur nga aplikuesi në aplikim. Formulari i vendimit IDO parashikon dy kuti: të importit dhe të eksportit. Plotësohet vetëm një kuti. Prandaj është i rëndësishëm dhënia e këtij elementi te të dhënat nga aplikuesi.

8/4 Mostrat, broshura etj, (kutia 18 e formularit të vendimit IDO)

Elementet e përshkruara në vendim i referohen elementeve të aplikimit. Megjithatë, nëse mostrat, broshurat etj, nuk e ndihmojnë autoritetin doganor në marrjen e vendimit, këto elemente nuk duhet të pasqyrohen në vendim.

8/9 Fjalët kyçe (kutia 17 e formularit të vendimit IDO)

Shënohen nga DPD fjalë kyçe përkatëse sipas të cilave është indeksuar vendimi IDO. Ky indeksim, pra duke shtuar fjalët kyçe, lehtëson identifikimin e vendimeve IDO.

Për shembull, autoriteti doganor mund të evidentojë përshkrimin e mallit, llojin e transaksionit, vendin e importit ose eksportit, etj.

III/2 Përbërja e mallrave (kutia 7 e formularit të vendimit IDO)

Ky informacion pasqyrohet në vendim në qoftë se ai është një element i përshtatshëm për përcaktimin e origjinës.

III/4 Përcaktimi se cilat të dhëna duhet të trajtohen si konfidenciale

Të dhënat të cilat aplikuesi i ka përcaktuar si konfidenciale në aplikimin IDO, si dhe çdo informacion i shtuar nga DPD të cilin ajo e konsideron konfidencial, shënohen si të tilla në vendim. Çdo informacion, i cili nuk emërtohet konfidencial në vendim, mund të bëhet i disponueshëm në internet.

III/5 Vendi i origjinës dhe kuadri ligjor (kutia 8 e formularit të vendimit IDO)

Në kutinë 8 të formularit të vendimit IDO, pasqyrohet vendi i origjinës i përcaktuar nga DPD për mallrat përfundimtare të cilat është lëshuar vendimi dhe të dhëna të kuadrit ligjor (referencia për marrëveshjen jo-preferenciale/preferenciale, konventën, vendimin, rregulloren, etj).

Në rastin kur nuk përfshihet origjina preferenciale për mallrat në fjalë, në vendimin IDO, vendoset termi "jo-origjinuese" dhe referencia e kuadrit ligjor.

III/6 Justifikimi i vlerësimit të origjinës (kutia 9 e formularit të vendimit IDO)

DPD justifikon vlerësimin e origjinës. Në këtë pjesë jepen detaje të mjaftueshme me qëllim që mbajtësi të kuptojë saktë arsyetimin ligjor të autoritetit doganor.

Në rast se një IDO lëshohet përfundimtare për një kre të ri të Sistemit të Harmonizuar, bazuar në përditësimin e nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar, përfundimtare përfundimtare nuk ka rregull të origjinës që i përket atij kreun, origjina përcaktohet bazuar në rregullin ekzistues përfundimtare të mëparshëm. Për shembull, në bazë të SH 2017 një 'shkop mbajtës përfundimtare celular' klasifikohet në kreun 9620 të SH, kreun i cili nuk ka qenë në versionin e mëparshëm të SH.

Për më tepër, kur është e nevojshme, në vendim tregohet llogaritja e vlerës së shtuar. Gjithashtu, vendimi duhet të saktësojë se duhet të respektohen rregulla të caktuara të protokollit të origjinës (parimi i territorialitetit, rregulli mbi ndalimin e tërheqjes nga pagesa e Taksës Doganore, transportit të

drejtpërdrejtë, procedurat që lidhen me provat e origjinës). Një vendim IDO i tillë nuk jep të drejtën për të përfshuar një trajtim tarifor preferencial.

Edhe në qoftë se rregullat e përmendura më lart merren si të mirëqena, DPD mund të japë disa detaje nëse i konsideron të nevojshme.

III/7 Çmimi Ex-Works/çmimi i fabrikës (kutia 10 e formularit të vendimit IDO)

Duhet të tregohet çmimi Ex-Works/çmimi i fabrikës nëse ky informacion do të përdoret për të përcaktuar origjinën.

III/8 Materialet përdorura, vendi i origjinës, Kreu SH/Kodi NK dhe vlera (kutia 12 e formularit të vendimit IDO)

Në kutinë 12 të formularit të vendimit IDO, jepet informacion për materialet kryesore të përdorura si dhe përvendin e origjinës, kodin e nomenklaturës së kombinuar dhe vlerën e tyre, nëse kërkohen për përcaktimin e origjinës. Vend i origjinës së materialeve të përdorura duhet të përcaktohet sipas të njëjtë kuadër ligjor me atë të përdorur për produktin përfundimtar. Nomenklatura e mallrave ose e produktit duhet të jetë në nivelin 4-shifror, nëse rregulli në listë ³nuk kërkon më shumë detaje. Përshkrimi i materialeve të përdorura është gjithmonë i nevojshëm, sidomos në rastet kur rregulli në listë ka nënndarje të cilat nuk korrespondojnë me klasifikimin tarifor.

III/9 Përshkrimi i përpunimit /transformimit në mënyrë që të përfshitet origjina (kutia 14 e formularit të vendimit IDO)

Përshkrimi i përpunimit/transformimit në mënyrë që të përfshitet origjina është veçanërisht i rëndësishëm, kur rregulli në listë është një punim apo përpunim specifik, ose në raste të punimeve apo të përpunimeve të pamjaftueshme. DPD përdor elementet e dhëna nga aplikuesi në aplikimin e tij, (III/3 – Informacioni që mundëson përcaktimin e origjinës), për vlerësimin e proceseve të përdorura dhe operacioneve të kryera nga prodhuesi.

4.4 Njoftimi i vendimeve IDO

Sipas nenit 27 pika 3 Kodi Doganor dhe nenit 35 Dispozitat Zbatuese, njoftimi i vendimit IDO përmajtësin bëhet brenda 120 ditëve, ose brenda afatit të zgjatur 150 ditë nga dita e pranimit të aplikimit dhe në përputhje me formularin e përcaktuar në Aneksin 12-02 të Shtojcës B Dispozitat Zbatuese. Kur të ketë sistem elektronik përmenaxhimin e vendimeve IDO, vendimi do të njoftohet në mënyrë elektronike, megjithatë vendimi do të jetë i printueshëm sipas kushteve të përshkruara lart.

5. Menaxhimi i vendimeve IDO

5.1 Përdorimi i vendimeve IDO (neni 28 pika 2, nenit 36 pika 4 shkronja b Kodi Doganor).

Mbajtësi i një vendimi IDO në import ose eksport, duhet ta përdorë atë, sa herë kryen një transaksion respektiv importi apo eksporti lidhur me mallrat që janë objekt i vendimit IDO. Numri i referencës IDO duhet të evidentohet në deklaratën doganore.

³ *Lista e Rregullave (Aneksi II i Konventës PEM) vendos kushtet që kërkohen të përbushen nga produktet, që të konsiderohen si të punuara ose përpunuara myftueshëm brenda kuptimit të nenit 5 të Shtojcës I të Konventës PEM*

Nëse mbajtësi ka treguar numrin e referencës IDO në një deklaratë doganore, autoriteti doganor mund të kërkojë që ai të paraqesë vendimin përkatës IDO.

Mbajtësi i vendimit duhet të informojë autoritetin doganor pa vonesë mbi çdo faktor të krijuar pas marrjes së vendimit, që mund të ndikojë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij, sipas nenit 28 pika 2 Kodi Doganor.

Autoriteti doganor duhet të sigurohet se mallrat e mbuluara nga deklarata doganore janë të njëjta me mallrat, përfshirë cilat është lëshuar vendimi IDO. I takon mbajtësit të vendimit IDO, që në kontekstin e një regjimi të veçantë doganor, të provojë nëse mallrat dhe rrëthanat në fjalë që përcaktojnë origjinën korrespondojnë në çdo aspekt me mallrat dhe rrëthanat e përshkruara në vendimin IDO në përpunëje me nenin 36 pika 4 shkonja b, Kodi Doganor.

5.2 Periudha e vlefshmërisë (neni 36 pika 3, Kodi Doganor)

Vendimet IDO janë të vlefshme përfshirë një periudhë prej tre vitesh nga data në të cilën vendimi hyn në fuqi. Megjithatë, vlefshmëria e tyre mund të anulohet apo revokohet edhe para kësaj periudhe.

5.3 Shtyrja e përdorimit të vendimeve IDO (neni 37 pika 9 Kodi Doganor dhe nenit 40 Dispozitat Zbatuese)

Në bazë të kërkesës, një vendim IDO mund të vazhdojë të përdoret përfshirë importin e mallrave, në zbatim të kontratave të detyrueshme të cilat janë të bazuara në këtë vendim dhe që janë nënshkruar para humbjes së vlefshmërisë ose revokimit të vendimit IDO. Shtyrja e përdorimit nuk mund të zbatohet kur vendimi IDO është marrë përfshirë mallra që eksportohen. Shtyrja e përdorimit të vendimit IDO nuk duhet të jetë më e gjatë se gjashtë muaj nga data në të cilën vendimi IDO humb vlefshmërinë apo është revokuar.

Në mënyrë që të përfitojë shtyrjen e përdorimit të një vendimi IDO, mbajtësi i këtij vendimi depoziton një aplikim pranë DPD e cila ka marrë vendimin, brenda 30 ditëve nga data në të cilën ky vendim humb vlefshmërinë ose revokohet. Në aplikim duhet të tregohen sasitë e mallrave përfshirë cilat kërkohet një periudhë shtyrjeje e përdorimit të vendimit. Autoriteti doganor merr një vendim përfshirë shtyrjen e përdorimit dhe njofton mbajtësin, pa vonesë, por jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën autoriteti doganor merr gjithë informacionin e kërkuar i cili mundëson marrjen e vendimit.

5.4 Pezullimet dhe rivlerësimet jo të zbatueshme përfshirë vendimet IDO (neni 28 pika 4 Kodi Doganor dhe nenit 41 Dispozitat Zbatuese)

Në raste të veçanta autoritetet doganore mund të pezullojnë vendimin, nëse nuk është rasti përfshirë anuluar, revokuar ose ndryshuar atë.

Nenet 23 deri në nenin 26 të Dispozitave Zbatuese, në lidhje me rivlerësimin dhe pezullimin e vendimeve, nuk zbatohen përfshirë vendimet që lidhen me informacionin detyruar.

5.5 Veprimet që kanë përfshirë qëllim të garantojnë një përcaktim korrekt dhe uniform të origjinës të përcaktuar në një vendim IDO (neni 36 Dispozitat Zbatuese).

DPD-ja i transmeton, periodikisht, degëve doganore, detajet përkatëse të vendimeve IDO me qëllim që autoritetet doganore të mbikëqyrin kushtet dhe kriteret që duhen përmblushur nga personi, të cilat i është dhënë vendimi i JDO. Autoritete Doganore gjithashtu mbikëqyrin përpunëshmërinë me detyrimet që rrjedhin prej vendimit.

Një nga arsyet kryesore për përdorimin e IDO është të sigurojë zbatimin uniform të legjislacionit doganor në kuadër të origjinës.

6. Përfundimi i vlefshmërisë së vendimeve IDO

6.1 Pushimi i vlefshmërisë (neni 37 pika 2 Kodi Doganor)

Vendimet IDO janë të vlefshme për një periudhë prej tre vjetësh nga data në të cilën vendimi hyn në fuqi. Megjithatë, një vendim IDO pushon së qëni i vlefshëm para përfundimit të kësaj periudhe në rastet kur:

- një ligj i miratuar ose një marrëveshje e nënshkruar ka hyrë në fuqi, dhe vendimi IDO nuk është më në përputhje me ligjin, me efekt që nga data e zbatimit të ligjit apo marrëveshjes;
- nuk është më në përputhje me Marrëveshjen mbi Rregullat e Origjinës, të vendosura nga Organizata Botërore e Tregtisë, ose me shënimet shpjeguese, ose me një opinion për origjinën të miratuar për interpretimin e kësaj Marrëveshjeje me efekt nga data e njoftimit të autoritetit doganor nga sekretariati i OBT në Shqipëri.

6.2 Anullimet (neni 31 pika 2, 3 dhe neni 37 pika 4 Kodi Doganor)

Në funksion të dispozitave përjashtuese të nenit 28 pika 3 dhe nenit 31 Kodi Doganor, vendimet IDO mund të anulohen kur ato, janë bazuar në informacione të pasakta ose të paplota, të dhëna nga aplikuesi.

Mbajtësi i vendimit do të njoftohet për anullimin e tij. Anulimi i vendimit hyn në fuqi në datën në të cilën aplikuesi e merr ose konsiderohet që ka marrë njoftimin.

DPD njofton mbajtësin e vendimit për anulimin e vendimit duke i komunikuar arsyet, mbi të cilat e mbështet vendimin e saj si dhe duke i dhënë edhe mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tij brenda një afati të caktuar, që nga data kur është bërë komunikimi.

6.3 Revokimi (neni 37 pika 5 dhe neni 37 pika 8 Kodi Doganor)

DPD në çdo kohë mund ta revokojë vendimin IDO kur ai nuk është në përputhje me legjislacionin doganor, ose në rast se një ose disa nga kushtet për të marrë vendimin nuk ishin apo nuk janë më të plotësuar.

Një vendim IDO nuk mund të revokohet me kërkesë të mbajtësit të vendimit.

Përveç kësaj, vendimet IDO revokohen në rrethanat e mëposhtme:

- kur nuk janë më në përputhje me legjislacionin që rregullon fushën specifike, për shkak të ndryshimit të këtij legjislacioni;
- në raste të tjera specifike.

Mbajtësi i vendimit do të njoftohet për revokimin e vendimit duke i komunikuar arsyet, mbi të cilat e mbështetet vendimin e tyre si dhe duke i dhënë edhe mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tij brenda një afati të caktuar, që nga data kur është bërë komunikimi. Revokimi i vendimit hyn në fuqi në datën në të cilën aplikuesi e merr ose konsiderohet që ka marrë njoftimin.

7. Publikimi i të dhënavëve përvendimet IDO

DPD mund ta servirë informacionin jo konfidencial të vendimeve IDO në faqen e internetit. Çdo bërje publike e të dhënavëve duhet të jetë në përputhje me legjilacionin përmbrojtjen e të dhënavëve personale. Elementet e mëposhtme mund të vihen në dispozicion përpublikun e gjërë në formën e një skedari pdf dhe mund të konsultohen online.

- Data e fillimit të vlefshmërisë;
- Data e ndërpërjes së vlefshmërisë;
- Klasifikimi i mallrave;
- Kuadri ligjor;
- origjina jo-preferenciale / preferenciale
- origjina e përeaktuar